

URDHËR
Nr. 183, datë 23.6.2014

PËR PËRGATITJEN DHE HARTIMIN E
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM
DHE INTEGRIM 2014 - 2020

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri”, miratuar me vendimin nr. 692, datë 10.11.2005 të Këshillit të Ministrave,

URDHËROJ:

1. Përgatitjen dhe finalizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014 – 2020, si sintezë e të gjitha politikave publike sektoriale e ndërsektoriale. Struktura e SKZHI-së 2014-2020 përcaktohet sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri, të udhëheqë procesin dhe të koordinojë institucionet qendrore për finalizimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 - 2020.

3. Titullarët e ministrave të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore, të sigurojnë zhvillimin e procesit, bashkëpunimin e nevojshëm, si dhe të përgatisin me cilësi dhe në afat të gjitha materialet e kërkuara për politikat sektoriale dhe të koordinuara nga Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri.

4. Politikat sektoriale që përfshihen në SKZHI 2014-2020, si edhe institucionet përgjegjëse për dërgimin e informacionit, përcaktohen sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij urdhri.

Data	Produkti	Përgjegjësia
20 korrik 2014	Pjesët e rishikuara për politikat sektoriale (draft 1)	Ministritë e linjës
20 korrik 2014	Kuadri makroekonomik i rishikuar 2014-2021	Ministria e Financave
20 korrik 2014	Nënkapitulli për integrimin europian	Ministria e Integritimit
20 gusht 2014	Pjesët e rishikuara për politikat sektoriale (draft 2)	Ministritë e linjës
30 shtator 2014	Drafti i konsoliduar i SKZHI-së për diskutim në KPS	DPZHFND/KPS
30 nëntor 2014	Takimet konsultuese të zhvilluara (shoqëria civile, grupet e interesit, donatorët, komisionet parlamentare)	DPZHFND
20 dhjetor 2014	Drafti përfundimtar i Strategjisë Kombëtare 2014-2020 për miratim në KPS	DPZHFND/KPS
24 dhjetor 2014	Miratimi i SKZHI-së 2014-2020	Këshilli i Ministrave

SHTOJCA 2

A.1 Struktura e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKZHI 2014-2020

Dokumenti i strategjisë kombëtare do të ketë strukturën e mëposhtme, sipas kapitujve përkatës:

- Hyrje

Pjesa hyrëse shpjegon se çfarë përfaqëson SKZHI-ja

5. Zbatimi i procesit dhe metodologjisë, si dhe respektimi i afateve të përcaktuara për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 2014-2020), të bëhen sipas shtojcave 1 dhe 4, bashkëlidhur të këtij urdhri.

6. Procesi i përgatitjes dhe hartimit të strategji kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale, si pjesë e pandarë e procesit të SKZHI-së, të koordinohet dhe orientohet nga Njësia e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pranë Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri, bazuar në aktet përkatëse ligjore.

7. Ngarkohen ministratë e linjës dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DEPZHFND), në Kryeministri, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1

GRAFIKU KOHOR PËR PËRGATITJEN E
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE
INTEGRIM (SKZHI) 2014-2020

Datat kryesore të kalendarit të SKZHI-së për 2014 dhe produktet e pritshme që lidhen me përgatitjen e SKZHI-së 2014-2020 jepen më poshtë:

në kuadër të planifikimit strategjik për njësitë e qeverisjes qendrore (Sistemit të Planifikimit të Integruar), cili është procesi i ndjekur në lidhje me hartimin e SKZHI-së 2014-2020. Gjithashtu, në këtë pjesë shpjegohet sfondi historik, në lidhje me dokumentet strategjike të deritanishme të Qeverisë Shqiptare. Në këtë kontekst, shpjegohet se cila është risia e SKZHI-së 2014-2020, në krahasim me dokumentet e tjera strategjike paraardhëse të hartuara nga Qeveria Shqiptare (Strategjia për Uljen e

Varfërisë, SKZHES, SKZHI 2007-2013). Në këtë pjesë paraqitet shkurtimisht përmbajtja dhe shtyllat kryesore të SKZHI-së 2014-2020.

Kapitulli 1: Pamje e përgjithshme

Ky kapitull hyrës përmban dy pjesë kryesore:

- Pjesa e parë fokusohet në analizën përmbledhëse për situatën për sektorët kryesorë në kuadër të zbatimit të SKZHI-së 2007-2013.

- Kjo pjesë hartohet nga Njësia e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik në varësi të Departamentit të Programimit të Zhvillimit Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, pranë Kryeministrit. Për të hartuar këtë pjesë, përdoren kryesisht dokumentet e lidhura me prioritetet e qeverisë, si Programi i Qeverisë, kontributet e ministrive të linjës, raportet e progresit të SKZHI-së të hartuara gjatë periudhës 2006-2012, raportet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare (si Banka Botërore, BE, etj.).

- Kjo pjesë konsiston në një përmbledhje të situatës aktuale, me ecurinë dhe problematikat, duke paraqitur shifra dhe tregues domethënës dhe të nivelit të lartë për aspekte të ndryshme të zhvillimit. Gjithashtu në këtë pjesë përmbledhen sfidat kryesore që paraqiten për zhvillimin e vendit në të ardhmen. Kjo pjesë është një përpyetje për t'i u përgjigjur pyetjes "Ku gjendet Shqipëria tani?", si pikënisje për të mbështetur reformat që parashikohen në kapitullin 2 dhe 3.

- Pjesa e dytë fokusohet në integrimin europian, duke paraqitur situatën në lidhje me 3 kriteret e Kopenhagenit. Kjo pjesë hartohet mbi bazën e kontributit të Ministrisë së Integrimit (MIE). MIE paraqet informacionin bazë në lidhje me ecurinë sipas kriterëve të Kopenhagenit, sfidat për përmbushjen e këtyre kriterëve, si edhe procesin e parashikuar nga Qeveria Shqiptare për anëtarësim të plotë në BE. Për këtë pjesë shfrytëzohen raportet e progresit të BE-së apo të vendit tonë, në lidhje me procesin e integrimit në BE, si edhe dokumente të tjera të rëndësishme të hartuara nga BE, si edhe institucione dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Kapitulli 2: Vizioni, fushat dhe qëllimet strategjike

Ky kapitull shpreh qartë vizionin e Qeverisë Shqiptare, duke iu përgjigjur pyetjes "Si dëshirojmë të jetë Shqipëria në 2020?". Ky vizion përcaktohet kryesisht nga angazhimi për integrimin europian, duke patur si objektiv madhor integrimin e plotë në BE. Vizioni, si edhe pjesët e tjera të strategjisë, do të konsultohen gjerësisht me publikun e gjerë, grupet e interesit, shoqërinë civile, donatorët etj.

Në kapitull paraqiten:

- Fushat/sectorët strategjikë: fushat/sectorët kryesorë prioritarë në të cilat Qeveria do të përqendrojë aktivitetet e veta, me synim arritjen e vizionit të përcaktuar më sipër.

- Qëllimet afatmesme dhe afatgjata prioritare për çdo fushë strategjike. Këto qëllime përshkruhen në mënyrë koncize për periudhën afatmesme (2014-2017) dhe afatgjatë (2017-2020). Çdo fushë strategjike mund të ketë një ose më shumë qëllime strategjike, të cilat duhet të

përmbajnë rezultate specifike, qartësisht të matshme, të prekshme dhe të realizueshme në një kuadër të përcaktuar kohor dhe që ndikohen plotësisht nga aktivitetet e qeverisë.

- Shtyllat kryesore të strategjisë. Në varësi nga vizioni që do të përcaktohet nga Qeveria Shqiptare për zhvillimin e vendit, duke reflektuar edhe mendimin e grupeve të interesit të përfshira në procesin e konsultimit të SKZHI-së, do të paraqiten shtyllat kryesore, ku do të bazohet SKZHI-ja. Këto shtylla do të përbëjnë edhe orientimin e politikave strategjike dhe objektivave të politikave për kapitullin 3.

Kapitulli 3: Politikat strategjike dhe objektivat e politikave

Kapitulli 3, si pjesë thelbësore e dokumentit të SKZHI-së, paraqet politikat përparësore për çdo sektor/fushë/ndërsektor, që janë përcaktuar nga procesi i planifikimit kombëtar strategjik. Pra, çdo sektori të përfshirë në SKZHI, i nënrenditen politikat dhe objektivat e politikave për arritjen e qëllimeve strategjike të përshkruara në kapitullin 2.

Theksi vihet në paraqitjen e objektivave të politikave, duke siguruar lidhjen logjike midis qëllimeve strategjike për sektorët (sidomos sektorët prioritarë), politikave strategjike, si dhe objektivave të politikave për sektorët.

Fusha prioritare

→ Qëllimet strategjike (afatmesme & afatgjata)

→ Politikat për arritjen e qëllimeve

→ Objektivat konkrete (afatmesme & afatgjata)

Ky kapitull ndahet sipas shtyllave kryesore të përcaktuara në kapitullin 2 të vizionit. Në secilën prej këtyre shtyllave përfshihen pjesët e politikave për sektorët e veçantë dhe përkatës që përfshihen në një shtyllë të caktuar. Në shtojcën 3, pjesë e urdhrat, paraqitet lista e sektorëve që përfshihen në SKZHI 2014-2020.

Njësitë e qeverisjes qendrore dhe ministrinë e linjës duhet të përgatisin për çdo sektor të veçantë, nga një profil për sektorin, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Situata aktuale

- Vizioni: një pasqyrë e shkurtër, në të cilën përshkruhet gjendja e dëshirueshme e sektorit në 2020. Ky vizion shërben si pikënisje për procesin e planifikimit strategjik.

- Qëllimi i politikave prioritare për sektorin: Paraqitet veçanërisht për çdo politikë.

- Objektivat e politikave: Objektivat duhet të jenë specifike, të matshme, të prekshme, të arritshme, në një kuadër kohor të përcaktuar. Në disa raste, mund të paraqiten edhe produkte madhore në funksion të arritjes së objektivave të politikës.

Në dokumentin e SKZHI-së paraqitet një ekstrat i përmbledhur i profilit sektorial. Kontributi kryesor për këtë pjesë përcaktohet nga prioritetet e Qeverisë, planet e ministrive të linjës për 3 vitet 2014-2017, dokumente të tjera strategjike për sektorin (plane veprimi, letra

politikash, etj.), të cilat bashkërendohen pranë Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, sipas procesit të paraqitur në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij urdhri. Njësia e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik udhëheq përgatitjen e këtij kapitulli dhe finalizimin e tij, bazuar në kontributet e ministrive të linjës, institucioneve qendrore, si edhe aktorëve të tjerë, grupeve të interesit, shoqërisë civile etj.

Kapitulli 4: Kuadri makroekonomik dhe burimet financiare për zbatimin e strategjisë

Ky kapitull ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë paraqitet kuadri makroekonomik sipas skenarit makroekonomik të parashikuar, mbështetur mbi disa objektiva të përcaktuar të politikës fiskale. Përgatitja e kësaj pjese udhëhiqet nga Drejtoria e Politikave Makroekonomike pranë Ministrisë së Financave, në bashkëpunim dhe me përfshirjen edhe të Bankës së Shqipërisë. Kjo drejtori rishikon tre herë në vit kuadrin makroekonomik: në shkurt, qershor dhe tetor. Për hartimin e kuadrit makroekonomik për 2014-2020, do të merren parasysh kuadri makroekonomik 2014-2017 (i hartuar në janar 2014), marrëveshja me BB-në dhe FMN-në, parashikimet për financimet e huaja, si edhe IPA 2014-2020.

Kuadri makroekonomik 2014-2020 hartohet në qershor 2014 dhe është bazë për të përcaktuar tavanet paraprake për shpërndarjen e burimeve financiare për 2014-2020 për politikatat që zbatohen nga programet e PBA-në. Tavanet e buxhetit ndihmojnë ministrinë e linjës të shpërndajnë burimet financiare të nevojshme sipas viteve 2014-2020, si edhe të buxhetojnë politikatat përparësore. Këto tavanet publikohen nga Ministria e Financave në shkurt 2015, si pjesë e udhëzimit të PBA-së. Në muajin qershor 2014, me rishikimin e kuadrit makroekonomik kryhet edhe rishikimi i taveve të PBA për 2014-2017, të cilat publikohen në udhëzimin plotësues për përgatitjen e Buxhetit të Shtetit në korrik 2014. Ministrinë e linjës rishikojnë buxhetimin e politikave përparësore në përputhje me tavanet e rishikuara.

Në pjesën e dytë paraqitet kostimi i zbatimit të politikave të SKZHI-së për 2014-2020. Në këtë pjesë i jepet përgjigje pyetjes: “Cila është shpërndarja e burimeve financiare për realizimin e politikave përparësore të Qeverisë?”. Përgatitja e këtij kapitulli përgatitet me kontributin kryesor nga Drejtoria e Analizës dhe Politikave Buxhetore pranë Ministrisë së Financave. Megjithatë, puna e tyre do të varet krejtësisht nga përlogaritja nga ana e ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore për kostot për çdo politikë

përparësore të programeve të PBA 2014-2017 apo të strategjive sektoriale/ndërsektoriale. Kjo nënkupton një punë intensive dhe serioze nga ministrinë e linjës gjatë përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Gjatë përgatitjes së draftit përfundimtar të SKZHI-së, Njësia e Bashkërendimit të Strategjive paraqet alternativat për shpërndarjen e burimeve financiare përpara Komitetit të Planifikimit Strategjik, me qëllim marrjen e një vendimi politik për shpërndarjen e burimeve midis politikave përparësore.

Kapitulli 5: Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese

Në këtë kapitull paraqitet sistemi i monitorimit të SKZHI-së dhe strategjive sektoriale/ndërsektoriale, duke i dhënë përgjigje pyetjes “Si do ta masim ecurinë?”, “Çfarë instrumenti do të përdorim për të matur ecurinë?”, “Çfarë treguesish dhe synimesh do të përdorim?”, “Çfarë instrumenti do të përdorim për zbatimin e strategjisë dhe si lidhet SKZHI-ja me PBA-në?”, etj.

Në këtë kapitull përshkruhet mënyra e monitorimit të SKZHI-së, duke paraqitur instrumentin që përdoret për monitorim (Raporti i Progresit të SKZHI), si edhe procesin e hartimit, mënyrës së raportimit, si edhe konsultimit të raportit.

Gjithashtu, pjesë e këtij kapitulli është edhe përshkrimi i mekanizmit të monitorimit të performancës të strategjive sektoriale/ndërsektoriale.

Në këtë pjesë paraqitet edhe grupi i treguesve të përzgjedhur të nivelit të lartë, me synimet përkatëse afatmesme dhe afatgjata. Treguesit e nivelit të lartë janë kryesisht tregues të rezultateve, ecuria e të cilëve matet periodikisht.

Për identifikimin e këtyre treguesve kryhet një proces intensiv me kontribute të qenësishme nga INSTAT-i dhe ministrinë e linjës, për të përcaktuar fillimisht treguesit dhe pastaj edhe synimet përkatëse.

Treguesit duhet të lidhen me efektin dhe ndikimin e politikave të Qeverisë në nivel afatgjatë, në lidhje me arritjen e objektivave dhe qëllimeve të politikave. Pas procesit të konsultimit me INSTAT-in dhe ministrinë e linjës, përpilon listën përfundimtare me treguesit dhe synimet për 2014-2020, si edhe institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe publikimin e të dhënave. Kontributi kryesor përmbajtësor në përcaktimin e synimeve jepet nga ministrinë e linjës, ndërsa INSTAT-i jep kontribut për diskutimin në lidhje me çështje të metodologjisë, periodicitetit, çështjeve teknike të matjes, etj.

SHTOJCA 3

TABELA 1. LISTA E FUSHAVE DHE SEKTORËVE TË KAPITULLIT 3 TË SKZHI 2014-2020

Nr.	Pjesët e fushave dhe sektorëve për kapitullin 3	Njësitet e qeverisjes qendrore përgjegjëse për përgatitjen e materialeve për SKZHI 2014-2020
A	Integrimi në BE, politika e jashtme dhe e mbrojtjes	

1	Integrimi në BE	Ministria e Integrimit European
2	Politika e jashtme	Ministria e Punëve të Jashtme
3	Politika e mbrojtjes	Ministria e Mbrojtjes
B	Demokratizimi dhe shteti i së drejtës	
1	Drejtësia	Ministria e Drejtësisë; Prokuroria e Përgjithshme; Këshilli i Lartë i Drejtësisë; Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor
2	Të drejtat e pronës	Ministria e Drejtësisë (AKKP); Ministri Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (ASIG); MZHUT (ALUIZNI); ZRPP;
3	Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore; Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive; Kontrolli i Lartë i Shtetit
4	Menaxhimi i integruar i kufijve	Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
6	Krimi i organizuar, terrorizmi dhe trafikimi	MPB
7	Rendi publik	MPB
8	Administrata publike	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Inovacionin
9	Decentralizimi dhe reforma administrative territoriale	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
10	Të drejtat e njeriut	Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Avokati i Popullit; Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
11	Mediat	Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA); Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT)
12	Statistikat	INSTAT
13	Shoqëria civile	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile; Ministria e Integrimit
14	Parlamenti	Parlamenti; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
C	Zhvillimi ekonomik dhe social	
C.1	Infrastruktura	
1	Transporti	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
2	Energjetika	Ministria e Energjetikës
3	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
4	Menaxhimi i integruar i mbetjeve	MZHUT; MM, MTI
5	Shoqëria e informacionit dhe komunikimit	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Inovacionin
6	Mbrojtja e mjedisit	Ministria e Mjedisit
C.2	Ekonomia e tregut	
1	Financat publike	Ministria e Financave; Agjencia e Prokurimeve Publike; Kontrolli i Lartë i Shtetit
2	Sistemi financiar dhe monetar	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave
3	Nxjtja e biznesit dhe investimeve të huaja direkte	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria e Bujqësisë; Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
5	Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbikëqyrja e tregut	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; Ministria e Bujqësisë; Ministria e Shëndetësisë; Instituti i Ndërtimit; Enti i Banesave
6	Zhvillimi i turizmit	Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit
7	Kërkimi shkencor dhe inovacioni	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Inovacionin; Ministria e Arsimit dhe Sportit
8	Shoqëria e teknologjisë dhe inovacionit	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Inovacionin
C.3.	Politika sociale	
1	Punësimi	Ministria e Mirëqenies Sociale (MMS)
3	Barazia gjinore	MMS
4	Mbrojtja sociale dhe përfshirja sociale	MMS
5	Sigurimet shoqërore	MMS
6	Shëndetësia	Ministria e Shëndetësisë
7	Rinia	MMS
8	Arsimi parauniversitar dhe arsimi i lartë	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
9	Arsimi dhe kërkimi shkencor	MAS
10	Kultura	Ministria e Kulturës (MK)
11	Sporti	MAS
C.4	Zhvillimi rural dhe rajonal dhe urban	
1	Zhvillimi rajonal	FSHZH; MTI; MF; MBZHRAU, MAS
2	Zhvillimi rural dhe bujqësia	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)

3	Planifikimit hapësinor dhe zhvillimi urban	Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT)
4	Strehimi	MZHUT

SHTOJCA 4

METODOLOGJIA PËR PROCESIN E FINALIZIMIT
TË SKZHI 2014-2020

A. Hyrje: Sistemi i planifikimit të integruar

Planifikimi strategjik në Shqipëri bazohet mbi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është miratuar me fillimisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 21.4.2005 dhe më pas me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 10.11.2005¹.

SPI-ja ka si synim të sigurojë një kuadër të gjerë planifikimi, brenda të cilit të gjitha politikat dhe planifikimi financiar i qeverisë të funksionojnë në mënyrë koherente, efëiente dhe të integruar. SPI konsiston në një kuadër parimesh dhe strukturash operuese që mundësojnë lidhjen më të harmonizuar të mundshme të gjithë proceseve planifikuese mes tyre.

Dy janë proceset themelore ku mbështetet SPI-ja:

- Një proces afatmesëm deri në afatgjatë të planifikimit strategjik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e cila vendos prioritetet dhe qëllimet strategjike;

- Një proces i buxhetimit afatmesëm, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri të hartojë një plan trevjeçar brenda tavanëve të shpenzimeve buxhetore për të arritur objektivat e politikave, në përputhje me SKZHI-në;

Po kështu, në proceset e mësipërme të planifikimit strategjik dhe të buxhetimit duhet të pasqyrohen tërësisht edhe katër procese të tjera thelbësore:

- Programi i Qeverisë;

- Integrimi europian, d.m.th. zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe i Planit të Veprimit për Integrim Europian;

- Investimet publike;

- Ndihma e huaj, si pjesë.

Kuadri institucional i poshtëpërmendur do të përdoret për hartimin e SKZHI-së 2014-2020, përbën edhe strukturat institucionale ku mbështetet SPI-ja.

B. Lidhja e proceseve dhe risia e SKZHI-së 2014-2020 në kuadër të SPI-së

Metodologjia për procesin e hartimit të SKZHI-së 2014-2020 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të

gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar SPI. SKZHI 2014-2020 mbështetet veçanërisht në harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA. Në veçanti, SKZHI 2014-2020 kërkon:

- Lidhjen me prioritetet e Qeverisë Shqiptare, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë janë pjesë integrale e vizionit dhe politikave që përcakton SKZHI.

- Lidhjen e plotë midis PBA-së me PKZ-MSA, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA-së janë pjesë integrale e PBA-së dhe e SKZHI-së. Në këtë mënyrë përcaktohet deri në detaje kostoja e integritimit europian dhe angazhimeve në këtë kuadër.

- Harmonizimin më të mirë të PBA-së me SKZHI-në përmes:

- hartimit të një kuadri makroekonomik për 2014-2020, që përfshin prioritetet e politikave për 2014-2020, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat;

- objektivat e politikave të mirëpërcaktuara për 2014-2020, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritimit europian. Për këtë qëllim, udhëzimi për hartimin e buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së objektivave për 2014-2020 në PBA-në e ardhshme.

C. Kuadri institucional për hartimin e SKZHI-së 2014-2020

Niveli vendimmarrës

Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS). Kryen vendimmarrjen në nivelin më të lartë. KPS miraton draftin e SKZHI në të gjitha fazat e tij. Takimet kryesore të KPS-së, sipas kalendarit për hartimin e SKZHI-së, lidhen me:

- Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për 2014-2021;

- Miratimin e vizionit dhe objektivave sektorialë për SKZHI 2014-2020;

- Miratimin e draftit të kostuar të SKZHI 2014-2020;

- Miratimin e draftit final të SKZHI-së.

Niveli i lartë koordinues

Grupi Ndërmnistror i Punës për Koordinimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar. Luan rol kyç në koordinimin midis DPZHFNH-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritimit Europian. Takimet e këtij Grupi Ndërmnistror janë në funksion të parapërgatitjes së takimeve të KPS-së, me qëllim miratimin paraprak të materialeve që diskutohen në KPS.

Njësia operative

Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj (DPZHFNH) është i ngarkuar për hartimin e SKZHI 2014-2020. Njësia e

¹ Miratuar fillimisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 21.4.2005, "Për miratimin e strategjisë "Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar", i cili u shfuqizua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 10.11.2005, "Për miratimin e strategjisë së ripunuar "Konsolidimi i një sistemi planifikimit të integruar në Shqipëri".

Programimit të Zhvillimit dhe e Planifikimit Strategjik (NJPS), pjesë e Departamentit, është përgjegjëse për koordinimin e të gjitha proceseve dhe punës së institucioneve për hartimin e SKZHI 2014-2020, si edhe koordinimin e proceseve për draftimin e strategjive sektoriale e ndërsektoriale. DPZHFNH-ja ndjek ecurinë e procesit në ministritë e linjës dhe raporton pranë Kryeministrit për çështje të ndryshme në vazhdimësi.

Grupi teknik koordinues

Grupi i punës në nivelin teknik. Për bashkërendimin në nivel qendror të institucioneve kyçe të SPI-së dhe menaxhim të të gjithë procesit, funksionon një grup pune në nivel teknik me përfaqësues nga NJPS/DPZHFNH, Ministria e Financave Europian, Ministria e Integritimit Europian, INSTAT dhe Ministria e Ekonomisë:

Grupi i punës në nivelin teknik kryesohet nga drejtori i DPZHFNH-së (i cili mund t'ia delegojë detyrën drejtorit të NJPS në mungesë të tij) dhe koordinon punën për:

- përgatitjen e kapitullit të burimeve ekonomike për SKZHI 2014-2020 (përfshirë edhe kuadrin makroekonomik);
- përgatitjen e nënkaptullit të integritimit europian;
- përgatitjen e kapitullit të politikave sektoriale;
- përgatitjen e kapitullit të vizionit dhe përparësive strategjike;
- përgatitjen e kapitullit të monitorimit;
- përgatitjen e draftit të SKZHI-së.

Marrin pjesë kryesisht: NJPS/DPZHFNH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit/MF, Drejtoria e Politikave Makroekonomike/MF; Drejtoria e Programimit të Asistencës së BE/MIE; Drejtoria e Politikave Sektoriale/MIE, Drejtoria e Përgjithshme e Borsit/MF, Zyra e NAO/MF.

Ministria e Financave garanton lidhjen e PBA-së me procesin e SKZH 2014-2020. Ministria e Financave harton kapitullin e burimeve financiare që nevojiten për të zbatuar SKZHI 2014-2020, ku përfshihet edhe paraqitja e kuadrit makroekonomik e fiskal 2014-2020. Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Politikave Makroekonomike e Fiskale, Drejtoria e Borsit, zyra e NAOs, etj.

Ministria e Integritimit Europian garanton lidhjen e Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKNIE) me PBA-së me procesin e SKZH 2014-2020. Ministria e Integritimit përgatit nënkaptullin për perspektivën e integritimit europian në SKZHI 2014-2020, si edhe analizon të gjithë draftin për të dhënë inpute në lidhje me çështje të lidhura me integrimin në BE (përafrimi i legjislacionit, përputhja me *acquis communautaire* etj.). Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoritë që kanë në funksionin e tyre: çështje të programimit IPA, si edhe drejtoritë për çështjet sektoriale dhe integrimin në BE.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) garanton përputhjen e SKZHI-së me planifikimin e investimeve publike. Në proces përfshihen

ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoritë që kanë në funksionin e tyre: planifikimin dhe programimin e investimeve publike, si edhe politikave ekonomike.

Strukturat koordinuese në ministritë e linjës:

Sekretariati *ad-hoc* për SKZHI. Përbëhet nga një person kontakti për çdo ministri linje, që kryeson sekretariatit, me anëtarë personat përgjegjës për fushat specifike. Kjo është një strukturë mbështetëse e posaçme pranë Sekretarit të Përgjithshëm, që ngrihet me urdhër të ministrit. Sekretaria është pikë kontakti për DPZHFNH-në për procesin e hartimit të SKZHI-së. Kjo strukturë e posaçme garanton kontrollin e cilësisë për çdo dokument të draftuar dhe diskutuar nga drejtoritë e politikave dhe GMS, si edhe eficiencën dhe efektivitetin për procesin e hartimit të SKZHI-së 2014-2020, dhe është përgjegjëse për:

- Ndjekjen dhe zbatimin e planit të punës për draftimin SKZHI;
- Raportimin pranë Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, në lidhje me ecurinë e procesit, si dhe relatojnë në GMS për problematikat për zgjidhje;
- Garanton koordinimin brenda ministrisë për të zbatuar planin e punës, në përputhje me kalendarin për hartimin e SKZHI-së;
- Garanton cilësinë dhe dërgimin në kohë të drafteve të strategjive;
- Siguron mbështetje teknike Sekretarit të Përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve koordinuese në funksion të draftimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale.

Grupet për Menaxhim Strategjik (GMS) në ministritë e linjës: të drejtuar nga ministrat përkatës dhe të koordinuar nga Sekretarët e Përgjithshëm, garantojnë përgatitjen e drafteve të strategjive sektoriale me proces të brendshëm diskutimi.

D. Fazat e procesit të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020

Mobilizimi i procesit me ML (qershor – korrik 2014)

Fillimisht, fokusi vendoset në lançimin e procesit me ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe përgatitjen e strukturave përkatëse që angazhohen në proces. Aktivitetet kryesore që zhvillohen gjatë kësaj faze, organizohen nga Njësia e Programimit të Zhvillimit dhe e Planifikimit Strategjik (NJPS)/ DPZHFNH.

- Lançimi i procesit në takimin me sekretarët e përgjithshëm (qershor 2014)

- Organizimi i sekretariateve *ad-hoc* në ML-të (qershor 2014)

- Takimet të veçanta me çdo ministri linje. Përmes sekretariateve, organizohen takimet me sekretarët e përgjithshëm, si edhe drejtorët e politikave (qershor 2014).

Ministria e Financave është përgjegjëse për:

- Hartimin e kuadrit makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2014-2022 (qershor - korrik 2014).

- Rishikimi i tavanëve për PBA 2015-2017, si edhe buxhetit për 2015 (korrik 2014).

Sekretariatet *ad-hoc* në ministritë e linjës gjatë fazës

së parë janë përgjegjëse për:

- Ngritjen me urdhër ministri të Sekretariatit *ad-hoc* për SKZHI-në 2014-2020 për çdo ministri linje (qershor 2014).

- Hartimin e planeve të punës, në përputhje me kalendarin për hartimin e SKZHI 2014-2020 (korrik 2014).

Finalizimi i konsultimit të SKZHI-së 2014-2020 (nëntor-dhjetor 2014)

Fokusi është finalizimi i SKZHI-së 2014- 2020, si edhe draftimi i strategjive sektoriale e ndërsektoriale, në funksion të hartimit të SKZHI-së 2014-2020.

Përgjegjësit kryesorë institucionalë në këtë fazë janë:

Njësia e Programimit të Zhvillimit dhe e Planifikimit Strategjik (NJPS)/ DPZHFNH:

- Përgatitja e komenteve për draftet e para për politikat sektoriale nga ministrinë e linjës (gusht 2014);

- Analiza dhe rishikimi i deklaratave të politikave të programeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritetit (shtator 2014);

- Paraqitja në Komitetin e Planifikimit Strategjik të draftit të parë të SKZHI (shtator 2014);

- Hartimi i kapitullit të burimeve financiare për SKZHI (shtator 2014);

- Rishikimi dhe përgatitja e draftit për konsultim të SKZHI-së (nëntor - dhjetor 2014);

- Konsultimi i SKZHI-së 2014-2020 me: grupet e interesit dhe partnerët socialë, donatorët dhe komisionet parlamentare (dhjetor 2014);

- Finalizimi i draftit dhe paraqitja për diskutim në KPS (dhjetor 2014);

- Hartimi i treguesve për SKZHI 2014-2020 (qershor-shtator 2014).

Ministria e Financave:

- Përgatitja dhe dërgimi tek ML të udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit, së bashku me tavanet (pjesa B) deri në 2020 të rishikuara (korrik 2014);

- Kryerja e analizave të kërkesave buxhetore dhe organizimi i seancave dëgjimore me ML, në bashkëpunim me DPZHFNH dhe MIE (shtator 2014);

- Përgatitja dhe miratimi në KPS i kuadrit makroekonomik të rishikuar për 2014-2020 (tetor 2014);

- Përgatitja dhe miratimi në KPS i projektbuxhetit vjetor dhe i dokumentit të PBA-së 2014-2015 (tetor 2014);

- Draftimi i kapitullit të SKZHI-së për burimet financiare dhe parashikimet makroekonomike, për draftin që miratohet në KPS dhe konsultohet (tetor 2014);

- Finalizimi i kapitullit të SKZHI për burimet financiare, sipas kuadrit të rishikuar makroekonomik (janar 2014);

- Hartimi i treguesve financiarë për SKZHI 2014-2020 (qershor – shtator 2014).

Ministria e Integritetit Europian:

- Draftimi i nënkapitullit të integritetit europian për SKZHI 2014-2020 (korrik 2014);

- Paraqitja e komenteve për politikat sektoriale (shtator 2014);

- Kryerja e analizave të deklaratave të politikave të programeve, për të garantuar përfshirjen e PKZMSA-së në PBA (shtator 2014);

- Finalizimi i kapitullit të integritetit europian për SKZHI 2014-2020 (shtator - tetor 2014);

- Dhënia e komenteve përfundimtare mbi draftin (tetor 2014);

- Hartimi i treguesve të lidhur me integrimin europian për SKZHI 2014-2020 (qershor-shtator 2014).

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS):

- Hartimi i komenteve për PBA 2015-2017 për investimet publike të planifikuara (gusht-shtator 2014);

- Hartimi i komenteve për draftin e SKZHI nga pikëpamja e përputhjes me planifikimin e investimeve publike (shtator 2014);

- Hartimi i treguesve ekonomikë për SKZHI 2014-2020 (qershor – shtator 2014).

Ministritë e linjës:

- Planifikimi i shpenzimeve të programeve buxhetore për 2015-2017, duke përfshirë edhe PKNIE-në, sipas udhëzimit të përgatitjes së PBA-së, pjesa A, ku specifikohet mënyra e kryerjes duke përdorur softin e PSHIP. Plotësimi i plotë i këtyre formularëve është një hap i parë i rëndësishëm për llogaritjen e kostos së SKZHI (si edhe strategjive sektoriale) (korrik 2014).

- Rishikimi i politikave sektoriale, për kapitullin 3 të SKZHI (korrik-gusht), të cilat duhet të përfshijnë të gjitha angazhimet e politikave të ministrive të linjës lidhur me:

- Programin e Qeverisë;

- Prioritetet e ML-ve në kuadër të jetësimit të prioritetëve;

- Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit;

- Marrëveshje dhe angazhime të tjera të Qeverisë;

- Raportet e Komisionit Evropian;

- çdo dokument tjetër strategjik sektorial dhe ndërsektorial ekzistues.

Hartimi i treguesve sektorialë për SKZHI 2014-2020 (qershor-shtator 2014).

